



Republika e Kosovës  
Republika Kosova/Republic of Kosovo  
Kuvendi Komunal Dragash  
Skupština Opštine Dragash/Dragash Municipality  
DREJTORIA PËR SHËNDETËSI DHE MIRËQENIE SOCIALE  
Komuna e Dragashit  
Opština Dragash



Nr. 01/24  
Datë: 11.11.2024  
Dragash

OH Nr. Br. 500/01 - 29777/24  
M. M. 2024  
Dragash - Dragash

## Thirrje publike për Projekt Propozim me bashkëfinancim

Organizatata Jo-Qeveritare të regjistruara në Republikën e Kosovës, programi i punës i të cilave është i fokusuar në ofrimin e shërbimeve shëndetësore, sociale, kujdesit për qytetarët, kujdesit mjedisorë, ambiental, agrarë dhe edukimit, të aplikojnë për mbështetje financiare me bashkëfinancim.

### Qëllimi

Me anë të këtij projekti synohet mbështetja e të gjithë qytetarëve të Komunës së Dragashit në kujdesin shëndetësor, edukimin shëndetësor, kujdesin mjedisorë dhe agrarë, social, edukativo arsimor.

Të ndikojë në përmirësimin e gjendjes së përgjithshme të qytetarëve, përmirësimin e mirëqenies, përkrahjen me shërbime, ofrimin e shërbimeve të specializuara shëndetësore ndaj personave të moshuar në nevojë, të sëmurët kronikë dhe personat me nevoja të veçanta, personat me aftësi të kufizuara duke përfshi edhe fëmijët, invalidët e luftës etj.

### Kushtet për aplikim:

- Të drejtë aplikimi kanë OJQ-të, që janë të regjistruara në regjistrin e organizatave Jo-Qeveritare në Republikën e Kosovës,
- Të jenë të regjistruar dhe aktive sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi në Republikën e Kosovës;
- Të jenë të pajisur me numër fiskal sipas kërkesave të legjislacionit tatimor të Republikës së Kosovës;
- Të ketë kryer të gjitha detyrimet tatimore dhe kontributet tjera të detyrueshme në përputhje me legjislacionin në fuqi në Republikën e Kosovës
- Të mos jetë në proces falimentimi, në proces të shuarjes, në procedura të mbledhjes së detyrueshme apo likuidimit;
- Përqindja e bashkëfinancimit nga aplikanti duhet të jetë së paku 20% e vlerës totale të projekt-propozimit;



- Të posedojë licencë valide nga Ministria e Shëndetësisë për shërbime mjekësore dhe licencë për shërbime sociale të lëshuar nga Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve;
- Organizatat aplikuese të posedojnë edhe aktivitete në fushën e edukimit apo administrimit, mbrojtjes së ambientit, kujdesin social dhe të kenë eksperience në projekte të ngjajshme të dëshmuara me kontrata dhe referenca.
- OJQ-të, mund të aplikojnë vetëm me një projekt, me kohe të caktuar implementimi prej 12 muajve, duke e përshkruar dhe detajuar mirë Projekt Propozimin bazuar në qëllimet e thirrjes dhe detajimin e buxhetit për bashkëfinancim.

### **Organizatat përfituese**

Përfitues do të jetë një Organizatë Jo-Qeveritare.

### **Kohëzgjatja e aplikimit**

Afati për dorëzimin e propozimeve është **15 ditë**, nga data e hapjes së thirrjes publike **11.11.2024** dhe përfundon me datën **25.11.2024** ora **15:00**.

Projekt propozimet duhet të dorëzohen në kopje fizike në zyrën e pritjesë në Komunën e Dragashit.

Kërkesat e dërguara pas datës së fundit dhe kërkesat e pakomletuara nuk do të pranohen.

**Drejtori i DSHMS-së**

**Behar Brenolli**

